



Të dashur prindër



Së shpejti për fëmijën tuaj fillon koha e kopshtit.

Kjo do të thotë një hap i madh drejt pavarësisë, ku fëmija duhet të orientohet në një grup prej 16 deri në 24 fëmijë dhe me kujdestarë të rinj.

Ndoshta ju tashmë parashtroni pyetje rreth kësaj ngjarjeje.

Për shembull:

Si do ta përjetojë fëmija im hyrjen?

A do të mund të ndahet nga ne dhe a do ta fitojë besimin e kujdestarëve të rinj?

Si do të orientohet fëmija ynë me strukturat e reja ditore?

Cilat kërkesa priten nga fëmijët tanë?

Gjithashtu edhe ne edukatorët e kopshtit na preokupojnë për çdo vit të njëjtat pyetje dhe përpiqemi që fëmijëve ti mundësojmë një fillim të mbarë në kopsht.








Përballja me të gjitha këto pyetje ne na ka nxit që juve t'ju sqarojmë parakohe, se si ta përkrahni në shtëpi fëmijën tuaj, që hyrjen në kopsht ta përjetojë si një ngjarje pozitive.

Shembujt e mëposhtëm përkrahës janë menduar si propozime dhe në asnjë mënyrë të mos kuptohen si programe ushtrimore.

Në rrugën për një jetë të shëndoshë e të pavarur ne si edukatore jemi për çdo ditë të angazhuara fëmijën ta inkurajojmë dhe kthjellim që të mendojë për çdo gjë „unë mund ta bëjë këtë“.

Asgjë nuk e përforcon më shumë fëmijën tuaj se sa besimi që ja ofroni ju.

Unë jam e lumtur që t'ju njoh personalisht ju dhe fëmijën tuaj dhe ju pres me përshëndetje të ngrohta miqësore.

<p>Ndryshimet për fëmijën tuaj gjatë hyrjes në kopshtin e fëmijëve</p>	<p>Mbështetja paraprake në shtëpi para hyrjes në kopshtin e fëmijëve</p>
<p>Ndarja e përditshme me prindërit Një kohë më të gjatë i mbikqyrur nga të huajt</p> 	<p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Grup loje • Fëmija ha tek fëmija i fqinjtit • Luan tek një shok ose shoqe • Bën korrierin e pavarur (shpraz kutinë postare, heq mbeturinat, i kthen diçka të huazuar fqinjtit,...)
<p>Strukturat të reja ditore (orari mësimor) Nevojat të reja të gjumit</p> 	<p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshtatje e ritmit të gjumit me strukturat e reja • Orar i rregullt i gjumit • Gjum i mjaftueshëm
<p>Kryerje e pavarur e punëve të WC-së (përfshirë larjen e duarve)</p> 	<p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Lojë në parkun e lojrave • Shetitje... (ngjitje përpjetë, mbajtje e baraspeshës, lojë me top...) • Përjetim i natyrës në çfarëdoq moti
<p>Selbstständiges Erledigen von WC-Geschäften. (inkl. Händewaschen)</p> 	<p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ushtrime të përditshme
<p>Veshje dhe zhveshje e pavarur</p> 	<p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mundësisht planifikim i kohës së mjaftueshme gjatë ushtrimeve të përditshme (Mbërthim dhe zbrërthim i kopsave (pullave) dhe zinxhirëve, eventualisht lidhja e këpucëve)
<p>Kërkesat e përdorimit të lapsit, gërsërëve dhe objekteve të përditshme</p> 	<p><i>Shembuj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Oferta të materialeve dhe veglave të punës (gërsërë, lapsa me ngjyra, shkumësa, ngjyra uji, ngjitësa, shirita ngjitës...) i jepen fëmijës për ti provuar dhe eksperimentuar në përdorim të lirë • Ndhmë në kuzhinë (shtron, pret, mbush, përzien...) • Ndhmë në punët e shtëpisë
<p>Fëmija duhet të kuptohet me persona akoma jo të besueshëm</p> 	<p><i>Shembuj:</i> <i>Për zhvillimin e gjuhës mund të ndihmojnë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kqyrja e përbashkët e librave me ilustrime • Loja e përbashkët • Rrëfim i përrallave (p.sh. si një ritual për natën e mirë) • Dëgjim, zhvillim i bisedave <p>Zbatoni shembujt në gjuhën amtare. Vetëm kur gjuha amtare është e përforcuar, atëherë fëmija mund të mësojë një gjuhë të dytë.</p>